



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 korrik 2014
Nr. ref.:VMP675/14

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

Rastet Nr. KI99/14 dhe KI100/14

Parashtrues

Shyqyri Syla dhe Laura Pula

Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Shyqyri Syla (KI99/14), Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe znj. Laura Pula (KI100/14), Prokurore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës). Parashtruesit e kërkesës ishin kandidatë në procedurën e përzgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) konteston Vendimin KPK nr. 151/2014 e Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK), të 6 qershorit 2014, për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Në anën tjetër, parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14) e konteston Vendimin KPK/146/2014, të 5 qershorit 2014, lidhur me kërkesën e saj për rishqyrtimin e listës përfundimtare me pikët e vlerësimit të kandidatëve, të 31 majit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve që kanë të bëjnë me procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit në postin e Kryeprokurorit të Shtetit, përkatësisht Vendimit të KPK-së për nominimin dhe për propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit (KPK nr. 151/2014, të 6 qershorit 2014).
4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se KPK, gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të nominimit të kandidatit për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Parashtruesi i kërkesës (KI99/14, z. Shyqyri Syla) kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë procedurën e emërimit të kandidatit të nominuar.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 (3) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 12 qershor 2014, parashtruesit e kërkesës i dorëzuan kërkesat e tyre në mënyrë individuale në Gjykatë.
8. Më 17 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI99/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI39/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 17 qershor 2014, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesës KI100/14 me kërkesën KI99/14. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jenë të njëjtë, si ishte caktuar me vendimet e Kryetarit për caktimin e gjyqtarit raportues dhe të Kolegjit shqyrtues, më 17 qershor 2014.
10. Më 19 qershor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin dhe për bashkimin e kërkesave. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi KPK-së kopjet e kërkesave.
11. Më 24 qershor 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Presidentit të Republikës së Kosovës.
12. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendimet e caktuara të ngritura ndaj tij.
13. Më 3 korrik 2014, pasi dëgjoi gjyqtarin raportues dhe pasi diskutoi për qëndrimet e parashtruesve, të shprehura në parashtresat e tyre me shkrim, Gjykata vendosi të miratojë kërkesën për Masë të përkohshme deri në publikimin e vendimit të Gjykatës.

Përmbledhja e shkurtër e fakteve

14. Si rezultat i shpalljes së brendshme për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe të procedurës së përmbyllur të përzgjedhjes, parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Sylja, KI99/14) ishte ndër tre kandidatët e ranguar më së larti dhe që iu nënshtrua procedurës së votimit për të nominuarin për Kryeprokuror të Shtetit.
15. Më 6 qershor 2014, KPK-ja nxori vendimin KPK. nr. 151/2014 për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.
16. Më 13 qershor 2014, KPK-ja i dërgoi Presidentit të Republikës së Kosovës propozimin për emërimin e të nominuarit për Kryeprokuror të Shtetit.
17. Deri më sot, Presidenti i Republikës së Kosovës nuk ka nxjerrë dekret për emërimin e kandidatit të nominuar nga KPK-ja.

Kërkesa e parashtruesit

18. Parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Sylja, KI99/14) kërkon nga Gjykata:

“Anulimin e procesit zgjedhor dhe aplikimin e masës së përkohshme për ndalimin e dekretimit”.

Kërkesa për Masë të përkohshme

19. Siç u tha më lart, parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) kërkoi nga Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, gjegjësisht të pezullojë procedurën e emërimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës të kandidatit të nominuar.
20. Gjykata, në bazë të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 2, të Kushtetutës, të nenit 27 të Ligjit dhe të rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, gjen se kemi rast *prima facie* të kërkesës dhe se parashtruesi ka paraqitur mjaft argumente bindëse që emërimi i kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit nga Presidenti i Republikës së Kosovës mund të rezultojë me dëme të pariparueshme për parashtruesin e kërkesës.
21. Prandaj, miratohet kërkesa e parashtruesit për Masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 116, paragrafi 2, të Kushtetutës, në bazë të nenit 27 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 55 (4) dhe 56 (3) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOS

- I. TË MIRATOJË Masën e përkohshme;
- II. TË MIRATOJË Masën e përkohshme deri në publikimin e vendimit të Gjykatës dhe jo më vonë se deri më 1 gusht 2014, nga data e nxjerrjes së këtij vendimi;
- III. TË PEZULLOJË MENJËHERË procedurën e emërimit të kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit nga Presidenti i Republikës së Kosovës;
- IV. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;
- V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani